



Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

NDËRTIM EFICIENT

Niveli i katërt në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

K-B/1-IV-25

Tiranë 2025

¹Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi:	4
Kriteret e përgjithshme të pranimi:	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT.....	5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME (qëndrimet).....	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
NjN-02-IV-0242-25 Planifikimi dhe organizimi i punimeve të ndërtimit.....	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	5
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
NjN-02-IV-0243-25 Vizatimi teknik në fushën e ndërtimit.....	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	8
NjN-02-IV-0244-25 Dokumentacioni teknik në ndërtim.....	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	10
NjN-02-IV-0245-25 Punime për ndërtimin e strukturës së objektit	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	11
Kriteret e vlerësimit	12
NjN-02-IV-0246-25 Punime për ndërtimin e shtresave dhe dysHEMEVE	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	14
NjN-02-IV-0247-25 Punime të rifiniturave në ndërtim	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	15
Kriteret e vlerësimit	15
NjN-02-IV-0248-25 Monitorimi i punimeve të instalimeve elektrike, hidraulike, mekanike, teknologjike dhe të montimit.....	16
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	16
Kriteret e vlerësimit	17
NjN-02-IV-0249-25 Punime të infrastrukturës rrugore dhe sistemeve të kanalizimeve dhe shkarkimeve.....	17
Rezultatet e të nxënit në njohuri	17
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	18
Kriteret e vlerësimit	18
NjN-02-IV-0252-25 Kontrolli i cilësisë së punimeve në ndërtim	19

Rezultatet e të nxënit në njohuri	19
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	20
Kriteret e vlerësimit	20
NjN-02-IV-0250-25 Materialet në fushën e ndërtimit	21
Rezultatet e të nxënit në njohuri	21
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	22
Kriteret e vlerësimit	22
NjN-02-IV-0251-25 Mjetet dhe pajisjet e punës në fushën e ndërtimit	23
Rezultatet e të nxënit në njohuri	23
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	23
Kriteret e vlerësimit	23
NjN-24-IV-0253-25 Sipërmarrje, komunikimi etik dhe edukimi i karrierës	24
Rezultatet e të nxënit në njohuri	24
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	25
Kriteret e vlerësimit	25
NjN-02-IV-0254-25 Rregullat e sigorisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit në ndërtim eficient	26
Rezultatet e të nxënit në njohuri	26
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	27
Kriteret e vlerësimit	27
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	28
Modalitetet e vlerësimit	28
Informacion shtesë	29
SHËNIM	29

Emërtimi i kualifikimit	NDËRTIM EFICIENT			Kodi K-B/1-IV-25
Kohëzgjatja	6000 orë nocionale	Niveli	Niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK	
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Ndërtim eficient”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon, në nivelin teknik/menaxher i mesëm për t’u punësuar në fushën e ndërtimit dhe zbatimit të projekteve infrastrukturore apo për krijimin dhe menaxhimin e një biznesi privat, si person fizik ose juridik.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional “Ndërtim eficient”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që: - kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; - janë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryerjen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional; - pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Me përfundimin me sukses të kualifikimit profesional “Ndërtim eficient”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi pajiset me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të nivelit të teknikut të mesëm në këtë kualifikim profesional, që njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës si teknik/menaxher i mesëm ndërtimi në kuadrin e një biznesi individual në fushën e ndërtimit, në aktivitete si: karpentieri, hekurkthim dhe betonim, muratim-suvatim, shtrim dhe veshje me pllaka, punime dhe riparim rrugësh (përfshirë punime të infrastrukturës inxhinierike), punime dekorative dhe bojatisje, mirëmbajtje ndërtesash. Gjithashtu mund të punësohet dhe vetëpunësohet në njësi të prodhimit dhe të tregtimit të materialeve të ndërtimit. Me përfundimin e këtij kualifikimi profesional, individi mund të fitojë të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” dhe mundësinë për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Mars 2025			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme				

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Ndërtim eficient” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individit duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME (qëndrimet)

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të qenë pjesëmarrës proaktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
15. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-02-IV-0242-25 Planifikimi dhe organizimi i punimeve të ndërtimit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë legjislacionin në fuqi në fushën e ndërtimit (Udhëzimet, Vendimet e Këshillit të Ministrave, standardet dhe kushtet teknike të zbatimit);
2. Të shpjegojë tendencat e zhvillimit të fushës së ndërtimit në Shqipëri;
3. Të rendisë strukturat organizative të kompanisë sipas hierarkisë;
4. Të interpretojë zbërthimin e projekt-zbatimit, simbolet, shenjat dalluese në skica, detaje, preventivit etj.;
5. Të shpjegojë përdorimet e programeve Autocad, office etj., në fushën e ndërtimit;
6. Të shpjegojë planin e organizimit të punimeve dhe mënyrat e zbatimit të tij;
7. Të shpjegojë mënyrat e ngritjes dhe bazat e organizimit të kantierit;
8. Të interpretojë mënyrat e menaxhimit të kantierit;
9. Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të proceseve të punës dhe bazës materiale;
10. Të argumentojë rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore;
11. Të rendisë llojet e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve në punime gërmimi, betonimi, hekurkthimi, murature etj., duke shpjeguar përdorimet e tyre;
12. Të argumentojë domosdoshmërinë e kontrollit të funksionalitetit të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
13. Të shpjegojë rëndësinë e vendosjes dhe respektimit të radhës së punës në ndërtim;
14. Të shpjegojë elementët e një urdhri pune dhe mënyrën e zbatimit të tij, sipas porosive dhe udhëzimeve të inxhinierit;
15. Të vlerësojë rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit me eprorët dhe me grupe të tjera për mbarrëvajtjen e punës gjatë të gjitha proceseve;
16. Të përshkruajë ndarjen e detyrave për çdo specialist, sipas proceseve të punës;
17. Të argumentojë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
18. Të shpjegojë rëndësinë e sistemit dhe pastrimit të vendit të punës para, pas dhe gjatë punës;
19. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e raportimit për ecurinë e punës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të analizojë projekt-zbatimin e objektit, sipas hapave të punës;
2. Të planifikojë bazën materiale dhe burimet njerëzore sipas grafikut dhe preventivit të punimeve;
3. Të planifikojë makineritë, pajisjet dhe mjetet e punës, sipas proceseve të punës;
4. Të sigurojë mjetet, materialet dhe burimet e nevojshme për realizimin e punimeve;
5. Të kontrollojë ngritjen e kantierit sipas rregullave teknike dhe organizative;
6. Të bashkëpunojë me inxhinierë dhe specialistë të tjerë në hartimin e grafikut të punimeve dhe realizimin e proceseve të punës, sipas fazave të zbatimit të punimeve;
7. Të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike për çdo zë punimi;
8. Të raportojë për punën e kryer te eprorët sipas proceseve të punës dhe formateve të kërkuara.

Kriteret e vlerësimit

- Zbërthen planin topografik për të nxjerrë akset dhe kuotat e objektit duke bashkëpunuar me topografin;
- Zbërthen projektin arkitektonik sipas udhëzimeve të arkitektit;

- Zbërthen projektin konstruktiv sipas udhëzimeve të inxhinierit konstruktor;
- Zbërthen projektet elektrike, hidraulike, mekanike etj., sipas udhëzimeve të specialistëve përkatës;
- Planifikon proceset e punës sipas radhës së punimeve;
- Planifikon bazën materiale të nevojshme sipas specifikimeve teknike dhe preventivit të punimeve;
- Planifikon burimet njerëzore të nevojshme sipas grafikut të punimeve;
- Planifikon makineritë, pajisjet dhe mjetet e punës sipas proceseve të punës;
- Kontrollon dhe përzgjedh bazën materiale sipas planifikimit dhe proceseve të punës;
- Përzgjedh grupet e punës, sipas grafikut të punimeve;
- Siguron makineritë, pajisjet dhe mjetet e punës, sipas planifikimit dhe proceseve të punës;
- Kontrollon gatishmërinë për punë të makinerive, pajisjeve dhe mjeteve të punës, sipas proceseve të punës dhe udhëzimeve përkatëse;
- Kontrollon rrethimin e kantierit sipas planit të organizimit;
- Kontrollon vendosjen e kontejnerëve për stafin dhe grupet e punës, sipas planit të organizimit;
- Kontrollon vendosjen e kabinave të rojeve, sipas planit të organizimit;
- Kontrollon furnizimin me ujë, energji elektrike dhe internet të kantierit, sipas planit të organizimit;
- Bashkëpunon me inxhinierin e kantierit për hartimin e grafikut të punimeve, sipas proceseve të punës;
- Organizon punën me brigadierët, përgjegjësit e grupeve, sipas proceseve të punës;
- Kryen ndarjen e detyrave grupeve të punës, sipas grafikut të punimeve dhe proceseve të punës;
- Organizon vendin e punës sipas standardeve dhe kushteve teknike të zbatimit;
- Raporton punën e kryer te eprorët sipas proceseve të punës dhe formateve të kërkuara.

NjN-02-IV-0243-25 Vizatimi teknik në fushën e ndërtimit

Rezultatet e të nxënimit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë dhe qëllimin e vizatimit teknik;
2. Të listojë materialet, mjetet dhe pajisjet për skicat dhe vizatimet teknike të thjeshta;
3. Të lexojë simbolet, shenjat dalluese dhe shkrimin teknik që përdoren në vizatime të ndryshme të objekteve të thjeshta të ndërtimit;
4. Të lexojë vizatime dhe skica me përmasa të ndryshme;
5. Të shpjegojë shkallët e vizatimit të paraqitjes së trupave në vizatimin teknik;
6. Të përshkruajë llojet e projeksioneve dhe rrafshet e projektimit;
7. Të interpretojë pozicionin e përshtatshëm të modelit mësimor;
8. Të interpretojë prerje dhe seksione për pjesë të ndryshme të modelit mësimor;
9. Të interpretojë vizatime të elementeve përbërëse të planit të përgjithshëm;
10. Të lexojë vizatime të ndryshme skematike;
11. Të interpretojë vizatime dhe skica detajesh, planimetrisë, pamjes, prerjes, planit të themeleve, për një ndërtesë të thjeshtë;
12. Të përshkruajë vizatime të planimetrisë së kateve;
13. Të përshkruajë vizatime të planit të strukturave të ndërkateve dhe shkallëve;

14. Të përshkruajë vizatime të detajeve kryesore të ndërtesës;
15. Të interpretojë skica me përmasa të dhëna në planimetri dhe prerje për të gjitha llojet e muraturave, me materiale të ndryshme;
16. Të lexojë vizatime të elementeve të thjeshta konstruktive;
17. Të interpretojë fletët e vizatimeve të ndërtimit si fletët arkitektonike dhe fletët konstruktive të projektit të zbatimit të një objekti të thjeshtë 2kt;
18. Të lexojë skicat dhe shenjat konvencionale të instalimeve (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje-ftohje-ventilim, gaz etj.) të përdorura në një objekt të thjeshtë 2kt
19. Të shpjegojë paraqitjen në projeksionin me kuota numerike, pikën, segmentin, planin dhe sipërfaqen topografike;
20. Të përshkruajë llojet e hartave, shkallën e paraqitjes së tyre dhe shenjat dalluese.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë skica të thjeshta me dorë të lirë duke përdorur shkrimin teknik;
2. Të vizatojë detale të ndryshme duke vendosur përmasat dhe duke përdorur shkallët e vizatimit;
3. Të vizatojë modele të thjeshta me anë të pamjeve dhe aksonometrisë;
4. Të vizatojë prerje të thjeshta në modele ndërtimi dhe t'i ndajë ato në seksione;
5. Të vizatojë planimetri, pamje, prerje, plan themelesh etj., për një ndërtesë të thjeshtë;
6. Të skicojë detaje të thjeshta ku zbatohen punime hekurkthimi;
7. Të vizatojë elemente konstruktive të thjeshta;
8. Të kryejë vizatime të planimetrisë së kateve;
9. Të kryejë vizatime të planit të strukturave të ndërkateve dhe shkallëve;
10. Të paraqesë në projeksionin me kuota numerike, pikën, segmentin, planin dhe sipërfaqen topografike;
11. Të përpunojë fletët e vizatimeve të ndërtimit si fletët arkitektonike dhe fletët konstruktive të projektit të zbatimit të një objekti të thjeshtë 2kt;
12. Të vizatojë shenjat konvencionale të instalimeve (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje-ftohje-ventilim, gaz etj.) të përdorura në një objekt të thjeshtë 2kt;
13. Të identifikojë llojet e hartave, shkallën e paraqitjes së tyre dhe shenjat dalluese në to;
14. Të vizatojë projeksionin me kuota numerike të pikës, segmentit, planit dhe sipërfaqes topografike.

Kriteret e vlerësimit

- Vizaton skica të thjeshta me dorë të lirë duke përdorur shkrimin teknik;
- Vizaton detale të ndryshme duke vendosur përmasa sipas shkallës së vizatimit;
- Vizaton modele të thjeshta me anë të pamjeve dhe aksonometrisë;
- Vizaton prerje të thjeshta në modele ndërtimi dhe t'i ndajë ato në seksione;
- Vizaton planimetri, pamje, prerje, plan themelesh etj., për një ndërtesë të thjeshtë;
- Skicon detaje të thjeshta ku zbatohen punime hekurkthimi;
- Vizaton elemente konstruktive të thjeshta;
- Përpunon detaje të fletëve të vizatimeve teknike si arkitektonike dhe fletët konstruktive të projektit sipas kërkesës së projektuesit;

- Interpreton shenja konvencionale të instalimeve (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje-ftohje-ventilim, gaz etj.) të përdorura në një objekt të thjeshtë 2kt;
- Lexon harta, shkallët e paraqitjes së tyre dhe shenjat dalluese në to, sipas standardeve përkatëse;
- Vizaton projeksionin me kuota numerike të pikës, segmentit, planit dhe sipërfaqes topografike, sipas kushteve të projektit.

NjN-02-IV-0244-25 Dokumentacioni teknik në ndërtim

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë llojet e ndryshme të dokumentacionit teknik që mbahen në kantier;
2. Të listojë llojet e dokumenteve të nevojshme gjatë realizimit të projektit, (kontratat, protokollet, raporte të inspektimeve, planet e punës dhe të tjerë);
3. Të shpjegojë procedurat për hartimin dhe mbajtjen e dokumenteve ditore dhe periodike;
4. Të vlerësojë rëndësinë e ruajtjes dhe arkivimit të dosjes teknike të zbatimit të projektit, gjatë dhe pas përfundimit të punimeve;
5. Të përkufizojë metodat për instruktimin teknik të punëtorëve në kantier, duke përfshirë instruktimet e përditshme dhe periodike, si dhe procedurat e mbajtjes së regjistrave;
6. Të shpjegojë rëndësinë e mbledhjes së të dhënave në kohë sipas proceseve të kryera nga grupet e punës;
7. Të shpjegojë teknikat për menaxhimin e inventarit të materialeve, makinerive dhe pajisjeve;
8. Të shpjegojë procesin e hartimit të kohëshënuesve për specialistët dhe punëtorët, sipas punës së kryer;
9. Të argumentojë rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet eprorëve dhe kolegëve për përpilimin, mbledhjen dhe arkivimin e dokumentacionit në formë fizike dhe digjitale.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të bashkëpunojë me inxhinierin për mbajtjen e dokumentacionit teknik gjatë zbatimit të projektit, sipas formateve dhe udhëzimeve përkatëse;
2. Të mbajë ditarin e objektit sipas formateve dhe udhëzimeve përkatëse;
3. Të përgatisë informacion mbi ecurinë ditore të punimeve dhe dokumentimin e punimeve të maskuara, si dhe të gjithë dosjes teknike të zbatimit të projektit;
4. Të ruajë dokumentet e procesit të instruktimit teknik të punëtorëve në objekt sipas rregullores dhe proceseve të punës;
5. Të bashkëpunojë për mbledhjen dhe arkivimin e dokumentacionit sipas rregullores dhe proceseve të punës;
6. Të mbajë dokumentacionin e inventarit për materialet, makineritë dhe pajisjet, sipas rregullave teknike të shfrytëzimit;
7. Të përgatisë kohëshënuesin e punëtorëve dhe specialistëve sipas punës së kryer.

Kriteret e vlerësimit

- Bashkëpunon me inxhinierin për mbajtjen e librit të kantierit të ndërtimit sipas formateve dhe udhëzimeve përkatëse;
- Plotëson plane ditore, javore, mujore të punës deri në përfundim të projektit, sipas formateve dhe udhëzimeve përkatëse;
- Mban ditarin e objektit sipas formateve dhe udhëzimeve përkatëse;
- Përgatit informacionin mbi ecurinë ditore të punimeve gjatë zbatimit të projektit sipas udhëzimeve përkatëse;
- Harton procesverbalet e punimeve përfshirë edhe ato të maskuara sipas punimeve të kryera dhe formateve përkatëse;
- Plotëson akt-kontrollin e punimeve të kryera, duke bashkëpunuar me specialistët përkatës, sipas formateve të caktuara;
- Plotëson dosjen teknike të zbatimit të projektit në bashkëpunim me specialistët e tjerë, sipas radhës së kryerjes së punimeve;
- Ruan dokumentet e procesit të instruktimit teknik të punëtorëve në objekt sipas rregullores dhe proceseve të punës;
- Ndhmon në instruktimin teknik ditor dhe periodik të punëtorëve në objekt duke mbajtur një dokumentacion të plotë sipas rregullores dhe proceseve të punës;
- Bashkëpunon me inxhinierin e zbatimit të projektit për sigurimin/mbledhjen e dokumentacionit sipas rregullores dhe proceseve të punës;
- Bashkëpunon me inxhinierin e zbatimit të projektit për ruajtjen fizike dhe digjitale, arkivimin e dokumentacionit të mbledhur, sipas rregullores dhe proceseve të punës;
- Mban dokumentacionin e inventarit të materialeve sipas rregulloreve të brendshme të organizatës;
- Mban dokumentacionin e inventarit të makinerive e pajisjeve sipas rregullave teknike të shfrytëzimit;
- Harton kohëshënuesin manual ose elektronik të punëtorëve dhe specialistëve sipas punës së kryer;
- Dorëzon kohëshënuesin manual ose elektronik të punëtorëve te specialistët përkatës, sipas afateve dhe procedurave të caktuara.

NjN-02-IV-0245-25 Punime për ndërtimin e strukturës së objektit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me topografin për zbatimin e planit të piketimit;
2. Të përshkruajë masat mbrojtëse gjatë punimeve të gërmimit për sigurinë e objekteve të tjera dhe infrastrukturës nëntokësore;
3. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e ndërtimit, instalimit të paneleve, kallëpeve, lidhjeve dhe montimeve të tyre në formën e kërkuar;
4. Të përshkruajë llojet e aksesorëve lidhës (piastra, shufra metalike, rrjeta speciale etj.) dhe teknika e vendosjes së tyre, si dhe llojet e përforcimeve të betonit;
5. Të shpjegojë teknikat e prerjes, kthimit dhe lidhjes së shufrave përforcuese, sipas kërkesave të projektit;

6. Të kryejë kontrollet përfundimtare të pozicioneve të hekurit, distancave ndërmjet elementeve të strukturës, përpara procesit të betonimit;
7. Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e matjeve dhe shënjimeve të materialeve të ndryshme për ndërtimin e kallëpeve;
8. Të vlerësojë rëndësinë e kontrollit të ndërtimit të kallëpeve në elementet betonarme dhe llojet e tyre bazuar në afatet teknike të procesit të betonimit;
9. Të shpjegojë teknikat e realizimit të përforcimeve strukturale në rikonstruksione;
10. Të shpjegojë tipologjitë e izolimeve dhe teknikat përkatëse të realizimit të tyre;
11. Të shpjegojë teknikat e lyerjes së sipërfaqeve të dërrasave dhe paneleve me lëndët mbrojtëse përkatëse;
12. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat e montimit dhe çmontimit të skelerive dhe elementeve përforcuese;
13. Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së materialeve (recepturat e betonit, llacit etj. sipas markës së tij);
14. Të vlerësojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit të hedhjes së betonit sipas normave e standardeve ndërtimore;
15. Të listojë teknikat e vibrimit, rrafshimit, nivelimit të sipërfaqes së betonit sipas normave e standardeve ndërtimore;
16. Të shpjegojë teknikat e dizarmimit të kallëpeve sipas radhës së përcaktuar dhe afateve;
17. Të përshkruajë mënyrat e trajtimit të strukturave të betonuara;
18. Të shpjegojë teknikat e marrjes së kampionëve të kubikëve për testet e markës dhe konsistencës së betonit;
19. Të përshkruajë mënyrat dhe metodologjinë e përcaktimit të akseve dhe të piketimit të mureve, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit me topografin;
20. Të listojë llojet e muraturave;
21. Të shpjegojë teknikat e ndërtimit të muraturës;
22. Të argumentojë rëndësinë e kontrollit të muraturës;
23. Të përshkruajë teknikat dhe mënyrat e riparimeve të mundshme të sipërfaqeve të elementeve betonarme dhe të kontrollit të tyre;
24. Të përshkruajë mënyrën e aplikimit të materialit izolues;
25. Të argumentojë rëndësinë e vendosjeve së aksesoreve të ndryshëm (këndore, rrjetat, pikore);
26. Të vlerësojë rëndësinë e bashkëpunimit me brigadierët e disiplinave të ndryshme për mbarëvajtjen e punimeve të zbatimit

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të bashkëpunojë me topografin për piketimin dhe kuotat sipas projektit;
2. Të kontrollojë zbatimin e masave mbrojtëse gjatë punimeve të gërmimit për sigurinë e objekteve të tjera dhe infrastrukturës nëntokësore;
3. Të kontrollojë punimet për gërmimet dhe transportin e dherave sipas projektit teknik, rregullave dhe kërkesave mjedisore;
4. Të kontrollojë punimet për kthimin, lidhjen dhe vendosjen e hekurit, ndërtimin e kallëpeve në elementet betonarme dhe hedhjen e betonit në çdo element betonarme sipas normave teknike;

5. Të zbatojë teknikat e realizimit të përforcimeve strukturale në rikonstruksione;
6. Të kontrollojë procesin e trajtimit të strukturave të betonuara dhe dizarmimit sipas kushteve teknike të zbatimit;
7. Të kontrollojë punimet për montimin dhe çmontimin e skelerive dhe elementeve përforcues;
8. Të kontrollojë punimet për tipologjitë e hidroizolimeve dhe izolimeve;
9. Të kontrollojë punimet për ndërtimin e muraturës;
10. Të bashkëpunojnë me brigadierët e disiplinave të ndryshme për mbarëvajtjen e punimeve të zbatimit.

Kriteret e vlerësimit

- Bashkëpunon me topografin për piketimin e akseve të themelit sipas, projektit të zbatimit;
- Bashkëpunon me topografin për piketimin e akseve të muraturës, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon zbatimin e masave mbrojtëse gjatë punimeve të gërmimit për sigurinë e objekteve të tjera dhe infrastrukturës nëntokësore;
- Kontrollon punimet për gërmimin e dherave sipas projektit teknik, rregullave dhe kërkesave mjedisore;
- Kontrollon punimet për transportin e dherave sipas projektit teknik, rregullave dhe kërkesave mjedisore;
- Kontrollon punimet për prerjen dhe kthimin e armaturës sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon punimet për ndërtimin e kallëpeve sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon punimet për lidhjen e armaturës sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon punimet për vendosjen e armaturës sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon punimet për hedhjen e betonit në objekt sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon procesin e trajtimit të strukturave të betonuara sipas kushteve teknike të zbatimit;
- Kontrollon zbatimin e teknikave të përforcimeve strukturale në rikonstruksione sipas projektit;
- Kontrollon punimet për dizarmimin e kallëpeve sipas kushteve teknike të zbatimit;
- Kontrollon punimet për montimin e skelerive sipas kushteve teknike të zbatimit;
- Kontrollon punimet për vendosjen e aksesorëve lidhës (piastra, shufra metalike, rrjeta speciale etj.) sipas kushteve teknike të zbatimit;
- Kontrollon punimet për çmontimin e skelerive, sipas kushteve teknike të zbatimit;
- Kontrollon punimet për hidroizolim të strukturës së themeleve, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon punimet për izolimet e strukturës së dysHEMEVE, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon punimet për izolimin e mureve, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon punimet për izolimin e tarracës, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon punimet për ndërtimin e muraturës prej tulle sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon punimet për ndërtimin e muraturës prej guri e materiale të tjera sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon punimet për ndërtimin e muraturës prej betoni sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon punimet për ndërtimin e muraturës së thatë sipas projektit të zbatimit;
- Bashkëpunon me brigadierët për mbarëvajtjen e punimeve sipas fazave të zbatimit të projektit.

NjN-02-IV-0246-25 Punime për ndërtimin e shtresave dhe dysHEMEVE

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me topografin për respektimin e piketimit dhe kuotave sipas projektit;
2. Të shpjegojë mënyrat e nivelimeve dhe rëndësinë e tyre;
3. Të argumentojë përdorimin e instrumenteve dhe mjeteve të matjes sipas llojeve të tyre;
4. Të argumentojë vendosjen e prioriteteve dhe radhës së punës në bashkëpunim me teknikë të tjerë për ndërtimin e shtresave dhe dysHEMEVE;
5. Të shpjegojë mënyrat e parapërgatitjes së sipërfaqeve të nënshtresave;
6. Të shpjegojë veglat dhe instrumentet për punimet e nënshtresave, shtresave niveluese dhe përdorimet e tyre;
7. Të shpjegojë mënyrat e realizimit të shtresave dhe veshjeve anësore të pllakave;
8. Të shpjegojë teknikat e ndërtimit të shtresave me mikroçimento, kuarce, rezina etj.;
9. Të shpjegojë teknikat e instalimit të dysHEMEVE teknologjike;
10. Të shpjegojë mënyrat e vendosjes së shtresave të gomuar, linoleume e plastike etj.;
11. Të shpjegojë teknikat e vendosjes së pllakave të gresit, porcelanit, pllakave të betonit në trotuare, sheshe etj.;
12. Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit të punimeve të shtrimit me pllaka;
13. Të përshkruajë teknikat e instalimit të dysHEMEVE me parket druri e laminat;
14. Të shpjegojë teknikat dhe mënyrat e riparimeve të mundshme të sipërfaqeve të shtresave;
15. Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit në proceset e riparimit dhe mirëmbajtjes së punimeve.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të bashkëpunojë me topografin për përcaktimin e piketimeve dhe kuotave sipas projektit;
2. Të kontrollojë punimet e nivelimeve dhe parapërgatitjes së sipërfaqeve të nënshtresave duke përdorur instrumentet dhe mjetet përkatëse;
3. Të vendosë prioritetet dhe radhën e punës në bashkëpunim me teknikë të tjerë për ndërtimin e shtresave dhe dysHEMEVE;
4. Të kontrollojë përdorimin e mjeteve, instrumenteve dhe materialeve të nevojshme sipas proceseve të punës për ndërtimin e shtresave dhe dysHEMEVE;
5. Të kontrollojë punimet e shtresave dhe veshjeve me pllakë;
6. Të kontrollojë punimet për ndërtimin e shtresave me mikroçimento, kuarce, rezina, shtresave të gomuar, linoleume e plastike, instalimin e dysHEMEVE teknologjike etj.;
7. Të kontrollojë punimet për vendosjen e pllakave të gresit, porcelanit, pllakave të betonit, të gurit në trotuare dhe sheshe etj.;
8. Të kontrollojë punimet për instalimin e dysHEMEVE me parket druri e laminat;
9. Të kontrollojë proceset e riparimeve dhe mirëmbajtjes së punimeve të shtresave.

Kriteret e vlerësimit

- Kontrollon vendosjen e piketimeve sipas udhëzimeve të topografit dhe projektit;
- Kontrollon vendosjen e kuotave sipas udhëzimeve të topografit dhe projektit;
- Kontrollon saktësinë e kuotave dhe pjerrësive sipas projektit, duke përdorur instrumentet përkatëse;
- Kontrollon vizualisht pastrimin e sipërfaqes nga mbetje të ndryshme;
- Kontrollon sasinë dhe cilësinë e materialeve të nënshtresave në përputhje me specifikimet e projektit;
- Vendos prioritetet dhe radhën e punës në bashkëpunim me teknikë të tjerë për ndërtimin e shtresave dhe dysHEMEVE;
- Bashkëpunon me teknikët e tjerë për të koordinuar radhën e punimeve hidraulike, elektrike, sistemi i ngrohje-ftohjes, etj., sipas grafikut të punimeve;
- Ndjek radhën e punës për ndërtimin e fashaturave sipas kuotës së dhënë nga topografi;
- Zbaton procedurën për ndërtimin e shtresave sipas projektit;
- Kontrollon punimet e shtresave në kuotë e cilësi, sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon vertikalitetin e shtresës anësore përpara dhe pas procesit të vendosjes së pllakave, duke përdorur mjetet e duhura;
- Kontrollon përgatitjen e materialeve lidhëse të shtrimit dhe veshjes me pllaka, sipas specifikimeve teknike dhe etiketës së ambalazhit;
- Kontrollon shtrimin dhe veshjen me pllaka, sipas projektit;
- Kontrollon përgatitjen e materialeve dhe mbushjen e fugave të pllakave, sipas specifikimeve teknike dhe etiketës së ambalazhit;
- Kontrollon zbatimin e metodologjisë së instalimit të dysHEMEVE teknologjike, sipas projektit;
- Kontrollon vendosjen e pllakave në horizontalitet ose me pjerrësi sipas projektit;
- Kontrollon drejtimin dhe gjerësinë e fugave sipas projektit;
- Kontrollon mbylljen e fugave me bojak (pllaka porcelan dhe gres) ose me rërë (pllaka betoni), sipas projektit;
- Kontrollon vendosjen në kuotë të binarëve të drurit për dysHEMENË me parket druri, sipas specifikimeve teknike të projektit;
- Kontrollon mënyrën e vendosjes së parketit sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon rashininimin dhe smerilimin e dysHEMESË së parketit prej druri sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon lyerjen e parketit me llak sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon vendosjen e batistopeve anësore për të mbyllur hapësirat midis parketit dhe mureve sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon vendosjen e nënshtresës (për parketet laminat) sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon vendosjen e parketit laminat sipas kërkesës së projektit;
- Kontrollon zbatimin e procedurave për prishjen e pjesës së dëmtuar, sipas udhëzimeve të specialistëve përkatës;
- Kontrollon zbatimin e procedurave për riparimin e pjesës së dëmtuar, sipas specifikimeve teknike;

- Kontrollon zbatimin e procedurave të mirëmbajtjes, sipas planifikimeve periodike.

NjN-02-IV-0247-25 Punime të rifiniturave në ndërtim

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit të punimeve të muraturë;
2. Të shpjegojë teknikat dhe mënyrat e suvatimit;
3. Të shpjegojë llojet e rrjetave dhe rëndësia e vendosjes së tyre;
4. Të shpjegojë llojet e stukimeve dhe patinimeve, sipas llojit të mureve dhe përdorimi i tyre;
5. Të argumentojë rëndësinë e smerilimit të sipërfaqeve me mjetet përkatëse dhe lyerjes me astar të sipërfaqeve;
6. Të shpjegojë llojet dhe procedurat e punimeve për veshjen e mureve të jashtme;
7. Të shpjegojë teknikat e realizimit të llojeve të ndryshme të punimeve dekorative dhe bojatisjeje;
8. Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit në punimet dekorative dhe bojatisje;
9. Të rendisë llojet e veglave dhe instrumenteve që nevojiten për punime të rifiniturës dhe përdorimet e tyre;
10. Të argumentojë rëndësinë e respektimit të radhës së punës për këto punime;
11. Të argumentojë interpretimin e skicave dhe detajeve të thjeshta për punime të strukturave të thata;
12. Të shpjegojë procedurat e montimit të dyerve tamburato, të drurit, duralumin etj.;
13. Të evidentojë procedurat e montimit të dritareve e fasadave të thjeshta me xham;
14. Të rendisë teknikat e përdorura në riparimin e sipërfaqeve të suvatuara, të lyera e të patinuara.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të kontrollojë punimet e sipërfaqes së murit;
2. Të kontrollojë zbatimin e teknikave të suvatimit;
3. Të kontrollojë zbatimin e teknikave të stukimit dhe patinimit;
4. Të kontrollojë zbatimin e punimeve për veshjen e mureve të jashtme;
5. Të kontrollojë realizimin e teknikave të punimeve dekorative dhe bojatisjes;
6. Të kontrollojë mënyrën e përzgjedhjes dhe përdorimit të veglave dhe instrumenteve për punime të rifiniturës;
7. Të kontrollojë punimet e strukturave të thata, duke zbatuar skicat dhe detajet e thjeshta për këto punime;
8. Të kontrollojë montimin e dyerve dhe dritareve në bashkëpunim me specialistët përkatës;
9. Të kontrollojë riparimin e sipërfaqeve të suvatuara, të lyera e të patinuara.

Kriteret e vlerësimit

- Kontrollon vertikalishtet e mureve, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura;
- Kontrollon defektet e sipërfaqes së muraturës, vizualisht dhe me pajisjet përkatëse;
- Kontrollon zbatimin e procedurave për riparimin e sipërfaqes së muraturës, sipas llojit të defektit dhe specifikimeve të projektit;
- Kontrollon zbatimin e fazave të suvatimit sipas specifikimeve teknike të projektit;

- Kontrollon përzgjedhjen e materialeve dhe mjeteve të punës, për stukimin dhe patinimin, sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon përgatitjen e materialeve për stukim dhe patinim, sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon zbatimin e procesit të stukimit, sipas specifikimeve teknike të projektit;
- Kontrollon zbatimin e procesit të patinimit, sipas specifikimeve teknike të projektit;
- Kontrollon përzgjedhjen e materialeve dhe mjeteve të punës, për veshjen e mureve të jashtme, sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon përgatitjen e materialeve për veshjen e mureve të jashtme, sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon zbatimin e fazave të veshjes së mureve të jashtme, sipas specifikimeve teknike të projektit;
- Kontrollon përzgjedhjen e materialeve dhe mjeteve të punës, për punime dekorative dhe bojatisje, sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon përgatitjen e materialeve për punime dekorative dhe bojatisje, sipas specifikimeve të projektit dhe instruksioneve të prodhuesit;
- Kontrollon zbatimin e teknikave dhe fazat për punime dekorative, sipas projektit;
- Kontrollon zbatimin e punimeve të bojatisjes, sipas projektit;
- Kontrollon përzgjedhjen e materialeve dhe mjeteve të punës, për punime të strukturave të thata, sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon zbatimin e teknikave për realizimin e strukturave të strukturave të thata, sipas projektit;
- Kontrollon montimin e dyerve, në bashkëpunim me specialistët përkatës, sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon montimin e dritareve, në bashkëpunim me specialistët përkatës, sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon zbatimin e procedurave për riparimin e sipërfaqes së dëmtuar, sipas llojit të dëmtimit.

NjN-02-IV-0248-25 Monitorimi i punimeve të instalimeve elektrike, hidraulike, mekanike, teknologjike dhe të montimit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit gjatë punimeve elektrike, mekanike, montimet, instalimet teknologjike etj., në përputhje me specifikimet teknike të projektit dhe në bashkëpunim me ekspertin përkatës;
2. Të shpjegojë rëndësinë e koordinimit dhe respektimit të radhës së punës për punimet elektrike, mekanike, montimet, instalimet teknologjike etj.;
3. Të interpretojë skica dhe detaje të thjeshta për instalimet elektrike;
4. Të interpretojë skica dhe detaje të thjeshta për instalimet hidraulike.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të interpretojë skica dhe detaje të thjeshta për instalime të ndryshme;

2. Të koordinojë radhën e punës për punimet elektrike, hidraulike, mekanike, montimet, instalimet teknologjike etj.;
3. Të kontrollojë punimet elektrike, hidraulike, mekanike, montimet, instalimet teknologjike etj., në bashkëpunim me specialistët përkatës, në përputhje me specifikimet teknike të projektit të zbatimit;

Kriteret e vlerësimit

- Interpreton skicat e thjeshta të instalimeve elektrike, sipas projektit përkatës;
- Interpreton skicat e thjeshta të instalimeve hidraulike, sipas projektit përkatës;
- Interpreton skicat e thjeshta të instalimeve teknologjike, sipas projektit përkatës;
- Koordinon radhën e punës për punimet elektrike, hidraulike, mekanike, montimet, instalimet teknologjike etj., në përputhje me grafikun e punimeve;
- Përcakton akset e piketimit për instalimin e linjave elektrike e hidraulike në bashkëpunim me topografin, sipas përcaktimeve të projektit të zbatimit;
- Kontrollon punimet elektrike sipas projektit të zbatimit, në bashkëpunim me specialistin e fushës;
- Kontrollon punimet hidraulike sipas projektit të zbatimit, në bashkëpunim me specialistin e fushës;
- Kontrollon punimet teknologjike sipas projektit të zbatimit, në bashkëpunim me specialistin e fushës;
- Kontrollon punimet mekanike sipas projektit të zbatimit, në bashkëpunim me specialistin e fushës.

NjN-02-IV-0249-25 Punime të infrastrukturës rrugore dhe sistemeve të kanalizimeve dhe shkarkimeve

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me topografin për përcaktimin e akseve dhe të piketimit të rrugës;
2. Të shpjegojë teknikat dhe metodat e përhapjes dhe ngjeshjes së çakëllit dhe stabilizantit;
3. Të shpjegojë teknikat e shtrimit, ngjeshjes dhe rulimit të shtresave asfaltike;
4. Të shpjegojë teknikat dhe mënyrat e ndërtimit të mureve prej guri, betoni, gabionet etj.;
5. Të interpretojë teknikat dhe mënyrat e ndërtimit të sipërfaqeve me beton të sprucuar;
6. Të shpjegojë teknikat dhe mënyrat e ndërtimit të mbrojtjes së skarpave;
7. Të përshkruajë teknikat dhe mënyrat e trajtimit të sipërfaqeve me gjelbërim;
8. Të shpjegojë teknikat dhe metodat e shpimit të tuneleve me makineri;
9. Të argumentojë metodat e vendosjes në vepër të tubave metalikë, korrugato, beton, betonarme, plastikë etj.;
10. Të vlerësojë rëndësinë e njohjes së teknologjisë së montimit të impianteve WWTP ;
11. Të shpjegojë teknikat dhe mënyrat e riparimeve të mundshme të shtresave të çakëllit dhe atyre asfaltike;
12. Të argumentojë rëndësinë e transportit të dherave në vendet e përcaktuara, sipas akteve ligjore në fuqi.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të marrë masa për vendosjen e sinjalistikës provizore rrugore sipas kushteve teknike të zbatimit;
2. Të drejtojë punimet për gërmimet sipas specifikimeve teknike;
3. Të mbikëqyrë vendosjen e materialeve hidroizoluese dhe gjeotekstil sipas projektit;
4. Të kontrollojë ngjeshjen e shtresave të çakëllit të thyer (nënbazës, bazës, stabilizantit) në rrugë sipas kërkesave të projektit;
5. Të kryejë kontrollin e punimeve për shtresat asfaltike sipas kushteve teknike të zbatimit;
6. Të drejtojë punimet për shtrimin e tubacioneve të furnizimit me ujë dhe për ndërtimin e kanaleve të hapura dhe kanaleve të mbyllura me betonarme, sipas standardeve e kushteve teknike të zbatimit;
7. Të drejtojë punimet për shtrimin e tubacioneve të shkarkimit dhe impianteve të trajtimit të ujërave të zeza e të shiut, sipas projektit.

Kriteret e vlerësimit

- Kontrollon akset, kuotat e rrugës dhe piketimin e veprave të artit, në bashkëpunim me topografin, sipas projektit të zbatimit;
- Koordinon mjetet e gërmimit, të transportit, mjetet e ngjeshjes dhe makineritë niveluese, sipas grafikut të punimeve;
- Kontrollon vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale provizore, sipas projektit;
- Kontrollon punimet e gërmimit, sipas kuotës së përcaktuar nga projekti;
- Kontrollon pjerrësitë e skarpave, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon vendosjen e materialeve mbrojtëse të skarpave, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon ngjeshjen e shtresës së gërmuar, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon vendosjen e gjeotekstit, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon vendosjen e materialeve hidroizoluese, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon mbushjen e shtresave të çakëllit, sipas kuotës së projektit;
- Kontrollon ngjeshjen e nënbazës dhe bazës së çakëllit të thyer sipas specifikimeve teknike;
- Kontrollon ngjeshjen e stabilizantit, sipas specifikimeve teknike;
- Kontrollon temperaturën e asfaltobetonit, sipas specifikimeve teknike;
- Kontrollon mënyrën e rulimit të shtresave asfaltike me rul, sipas kushteve teknike të zbatimit;
- Bashkëpunon me topografin për vendosjen e piketave për linjën e furnizimit me ujë, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon gërmimet në kuotë dhe në profil të kanalit ku do vendosen tubacionet, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon cilësinë e tubave sipas specifikimeve teknike;
- Bashkëpunon me specialistët përkatës për kontrollin e ngjitjes së tubave, sipas standardeve;
- Kontrollon vendosjen e tubacionit në kanal, në bashkëpunim me specialistët përkatës, sipas specifikimeve teknike të projektit;
- Kontrollon vendosjen e shtresës mbrojtëse të tubit poshtë, anash dhe sipër me materialin e përzgjedhur, sipas specifikimeve të projektit;

- Kontrollon mbushjen me material dhe ngjeshjen e tij, sipas specifikimeve të projektit të zbatimit;
- Kontrollon vendosjen e shiritit sinjalizues ujësjellës në kuotën e përcaktuar nga projekti;
- Kontrollon mbushjen përfundimtare dhe ngjeshjen e dheut, sipas projektit;
- Realizon provën me ngarkesë, me segmente, sipas specifikimeve teknike, në bashkëpunim me specialistët përkatës;
- Kontrollon vendosjen dhe heqjen e kallëpeve të dërrasës, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon vendosjen e armaturës së hekurit, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon procesin e betonimit dhe vibrimit, sipas kushteve teknike të zbatimit;
- Kontrollon nivelimin e sipërfaqeve të betonit, sipas kushteve teknike të zbatimit;
- Kontrollon mbushjen me dhë të veprave të betonuara sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon shtrimin e tubave të shkarkimit të ujërave të zeza e të shiut në pjerrësi, si dhe bashkimet e tyre, sipas specifikimeve të projektit;
- Kontrollon ndërtimin e kallëpeve në kuotë të pushtave, vendosjen e hekurit dhe procesin e betonimit të tyre, sipas projektit të zbatimit;
- Koordinon punët me specialistët përkatës për instalimin e impianteve, sipas grafikut të punimeve.

NjN-02-IV-0252-25 Kontrolli i cilësisë së punimeve në ndërtim

Rezultatet e të nxënësve në njohuri

1. Të argumentojë rëndësinë e testimit të përditshëm të ngjeshjes për cilësinë e rrugëve;
2. Të shpjegojë metodologjinë e testeve dhe kontrollin e cilësisë në kantier, të shtresave rrugore;
3. Të shpjegojë metodat e përdorura për kontrollin e horizontalitetit të shtresës së varfër të betonit;
4. Të shpjegojë metodat e kontrollit të kallëpeve të strukturave betonarme dhe të lidhjes së hekurit;
5. Të theksojë rëndësinë e testimit të materialeve në laborator për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e ndërtimit;
6. Të rendisë llojet e testeve që kryhen në laborator për materialet e ndërtimit;
7. Të klasifikojë mënyra/teknikat më të përdorura për marrjen e kampioneve të materialeve për testim;
8. Të shpjegojë rëndësinë e testimit të rregullt në kantier të konsistencës së betonit në çdo betoniere;
9. Të shpjegojë metodat e kontrollit të muraturës dhe rëndësinë e përdorimit të teknikave të sakta;
10. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të sipërfaqeve të suvatuara;
11. Të argumentojë rëndësinë e njohjes dhe përdorimit të teknikave të ndërtimit të strukturave të thata dhe proceset: si patinimi dhe lyerja;
12. Të shpjegojë mënyrat e monitorimit të testimit të rrjetit të sistemeve elektrike dhe hidraulike;
13. Të argumentojë rëndësinë e testimit të rregullt të makinerive ngritëse për sigurinë në kantier;
14. Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit të cilësisë së materialeve që do të përdoren sipas specifikimeve në projekt;
15. Të shpjegojë certifikatat e prodhimit dhe skedat teknike të materialeve;
16. Të theksojë rëndësinë e kontrollit të afateve të punës;
17. Të shpjegojë mënyrat për identifikimin dhe diagnostikimin e mangësive dhe defekteve të punimeve;

18. Të shpjegojë metodologjinë për korrigjimin e defekteve të punimeve në mënyrë efikase dhe të shpejtë;
19. Të theksojë rëndësinë e kontrollit të përputhshmërisë së materialeve me projektin dhe specifikimet teknike;
20. Të listojë standardet e cilësisë në industrinë e ndërtimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të kontrollojë zbatimin e punimeve të shtresave rrugore, sipas standardeve dhe specifikimeve teknike;
2. Të kontrollojë zbatimin e punimeve për realizimin e shtresës së varfër të betonit, kallëpeve dhe armaturës së hekurit sipas kushteve teknike të zbatimit;
3. Të kontrollojë zbatimin e procedurave për marrjen, në mënyrë të rregullt, kampioneve të materialeve të ndërtimit për testime laboratorike, sipas kërkesave teknike;
4. Të kryejë teste paraprake të konsistencës së betonit në çdo betonierë, sipas specifikimeve teknike;
5. Të kontrollojë procesin e ndërtimit të mureve, të sipërfaqeve të suvatuara dhe elementeve betonarme, sipas kërkesave të projektit;
6. Të kontrollojë zbatimin e punimeve të ndërtimit të strukturave të thata dhe proceset si: patinimi dhe lyerja, sipas kërkesave të projektit;
7. Të monitorojë realizimin e testeve të rrjeteve të sistemeve elektrike dhe hidraulike, si dhe të makinerive ngritëse në bashkëpunim me specialistët përkatës;
8. Të kontrollojë cilësinë e materialeve të përdorura bazuar në certifikatat e prodhimit dhe skedat teknike të tyre;
9. Të identifikojë mangësitë dhe defektet e punimeve duke përcaktuar edhe radhën për korrigjimin e tyre.

Kriteret e vlerësimit

- Kontrollon cilësinë e zbatimit të punimeve në vendosjen e shtresave rrugore, sipas standardeve dhe specifikimeve teknike;
- Kontrollon cilësinë e zbatimit të punimeve për shtresën e varfër të betonit, sipas kërkesave të projektit;
- Kontrollon cilësinë e zbatimit të punimeve në vendosjen e materialeve izoluese, sipas kushteve teknike të zbatimit;
- Kontrollon cilësinë e zbatimit të punimeve të kallëpeve të strukturave betonarme, sipas kushteve teknike të zbatimit;
- Kontrollon cilësinë e zbatimit të punimeve në lidhjen e armaturës në të gjitha elementët betonarme si, themele, kolona, tratë, arkitrarë, breza etj., sipas kërkesave të projektit;
- Kryen kontrollin përfundimtar të pozicioneve të hekurit, sipas kushteve teknike të zbatimit;
- Kryen kontrollin përfundimtar të përmasave të elementëve strukturorë, distancave ndërmjet elementeve të strukturës, përpara procesit të betonimit, sipas kushteve teknike të zbatimit;
- Kontrollon zbatimin e procedurave për marrjen e kampioneve të materialeve të ndërtimit për testime laboratorike, sipas kërkesave teknike;

- Kontrollon zbatimin e procedurave për marrjen e kampioneve të llaçeve për testime laboratorike për gjatë të gjitha proceseve të ndërtimit, sipas kërkesave teknike;
- Kontrollon zbatimin e procedurave për marrjen e kampioneve të betonit për testime laboratorike për të gjitha llojet e punimeve prej betoni të armuar, sipas kërkesave teknike;
- Kryen teste të konsistencës së betonit për çdo betonierë gjatë të gjitha proceseve të ndërtimit, sipas kërkesave teknike;
- Kontrollon vertikalitetin e murit në objekt, sipas kërkesave të projektit;
- Kontrollon vendosjen dhe lidhjen e arkitrarëve, brezave të betonit në mure, sipas projektit;
- Kontrollon vertikalitetin e të gjitha sipërfaqeve të suvatuara brenda dhe jashtë objektit, sipas projektit;
- Kryen kontrollin përfundimtar të përmasave të elementëve strukturorë, distancave ndërmjet elementeve të strukturës përpara procesit të betonimit, sipas kërkesave teknike;
- Kryen kontrollin përfundimtar të pozicioneve të hekurit në kallëpe përpara procesit të betonimit, sipas projektit;
- Kontrollon vertikalitetin e trarëve, arkitrarëve dhe brezave prej betoni të armuar, bazuar në projektin e zbatimit;
- Kontrollon vertikalitetin dhe horizontalitetin e shkallëve, sipas përmasave të projektit;
- Kontrollon zbatimin e punimeve të strukturave të thata, sipas standardeve dhe kushteve teknike;
- Kontrollon punimet për patinimin e mureve të thata, sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon punimet për lyerjen e mureve të thata, sipas projektit;
- Monitoron realizimin e testeve të rrjeteve elektrike dhe hidraulike, në bashkëpunim me specialistin përkatës, sipas projektit;
- Kontrollon përputhshmërinë e llaçit të përdorur në muraturë me specifikimet e projektit;
- Kontrollon përputhshmërinë e betonit të përdorur në elementet prej betoni të armuar me specifikimet e projektit;
- Korrigjon mangësitë dhe defektet e punimeve, sipas radhës së punimeve.

NjN-02-IV-0250-25 Materialet në fushën e ndërtimit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë llojet e materialeve përbërëse të llaçit dhe karakteristikat e tyre;
2. Të shpjegojë recepturat e materialeve përbërëse të llaçit për suvatime, sipas markës së dhënë;
3. Të listojë llojet e materialeve për punime betoni, karakteristikat dhe përdorimet e tyre;
4. Të shpjegojë recepturat e materialeve përbërëse të betonit, sipas markës së dhënë;
5. Të shpjegojë llojet e materialeve të ndryshme të muraturës, karakteristikat dhe përdorimet e tyre;
6. Të listojë llojet e materialeve për punime izolimi, karakteristikat dhe përdorimet e tyre;
7. Të tregojë llojet e materialeve për punimet e nënshtresave, shtresave niveluese dhe karakteristikat fiziko/mekanike të tyre;
8. Të shpjegojë llojet e materialeve për ndërtimin e shtresave dhe dysHEMEVE, karakteristikat, si dhe mënyrat e përgatitjes apo aplikimit të tyre;
9. Të listojë materialet drusore dhe nënproduktet e tyre për veshjen dhe shtrimin e sipërfaqeve;

10. Të listojë llojet e materialeve të ndryshme për ndërtimin e kallëpeve (dërrasave, binarëve, paneleve etj.), përbërësit, karakteristikat fiziko/teknike të tyre;
11. Të listojë llojet e materialeve për punimet e rifiniturës dhe përdorimit të tyre;
12. Të përshkruajë llojet e materialeve ndihmëse për realizimin e punimeve të suvatimit (rrjeta përforcimi, këndore metalike, pikore etj.);
13. Të tregojë llojet e materialeve të përdorura në prodhimin e dymave e dritareve;
14. Të listojë llojet e materialeve për punime në rrugë e kanalizime dhe përdorimet e tyre;
15. Të shpjegojë teknikat për menaxhimin e inventarit të materialeve në fushën e ndërtimit;
16. Të shpjegojë mënyrat e depozitimit dhe shpërndarjes së materialeve në vendin e punës;
17. Të shpjegojë certifikatat e prodhimit dhe skedat teknike të materialeve;
18. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të materialeve eficiente të ndërtimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kontrollojë zbatimin e recepturave të materialeve për përgatitjen e llaçit dhe betonit, sipas markave të dhëna;
2. Të kontrollojë përzgjedhjen e materialeve për ndërtimin e mureve bazuar në certifikatat e prodhimit, skedat teknike dhe përdorimit të tyre;
3. Të kontrollojë përzgjedhjen e materialeve për betonim bazuar në certifikatat e prodhimit dhe skedat teknike të tyre;
4. Të kontrollojë përzgjedhjen e materialeve për shtrim dhe veshje bazuar në certifikatat e prodhimit dhe skedat teknike të tyre;
5. Të kontrollojë përzgjedhjen e materialeve prej druri që përdoren në ndërtim;
6. Të bashkëpunojë për depozitimin, shpërndarjen dhe menaxhimin e inventarit të materialeve në fushën e ndërtimit;
7. Të përdorë materiale eficiente në procese të ndryshme të ndërtimit.

Kriteret e vlerësimit

- Kontrollon respektimin e recepturave të llaçit sipas përdorimit dhe markave të kërkuara;
- Kontrollon respektimin e recepturave të betonit sipas përdorimit dhe markave të kërkuara;
- Kontrollon përzgjedhjen e materialeve për ndërtimin e mureve sipas specifikimeve teknike të projektit;
- Kontrollon përzgjedhjen e materialeve izoluese të mureve bazuar në certifikatat e prodhimit, skedat teknike të tyre dhe specifikimeve të projektit;
- Kontrollon granulometrinë e materialit mbushës sipas specifikimeve teknike të projektit;
- Kontrollon llojet e armaturave për të gjitha markat e betonit, sipas specifikimeve teknike të projektit;
- Kontrollon cilësinë dhe llojet e pllakave të përdorura për shtrim dhe veshje, sipas specifikimeve teknike të projektit;
- Kontrollon llojet e materialeve termoizoluese të mureve të jashtme bazuar në certifikatat e prodhimit, skedat teknike të tyre dhe specifikimeve të projektit;

- Kontrollon llojet e materialeve prej druri që përdoren për ndërtimin e skelave dhe kallëpeve, sipas standardeve të zbatimit dhe specifikimeve të projektit;
- Kontrollon llojet e materialeve prej druri që përdoren për ndërtimin e mureve dhe dysHEMEVE ETJ., sipas standardeve të zbatimit dhe specifikimeve të projektit;
- Kontrollon përdorimin e materialeve eficiente në ndërtimin e fasadave;
- Kontrollon përdorimin e materialeve eficiente dhe ekologjike në ndërtimet e shtresave, veshjeve të mureve dhe strukturave tavanore.

NjN-02-IV-0251-25 Mjetet dhe pajisjet e punës në fushën e ndërtimit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë llojet e makinerive të gërmimit dhe transportit të dherave;
2. Të rendisë llojet e mjeteve dhe makinerive në punime betonimi;
3. Të listojë llojet e mjeteve dhe makinerive të hekurkthimit duke shpjeguar përdorimet e tyre;
4. Të rendisë llojet e mjeteve dhe makinerive në punime murature etj., duke shpjeguar përdorimet e tyre;
5. Të listojë llojet e mjeteve në punime suvatimi duke shpjeguar përdorimet e tyre;
6. Të listojë llojet e mjeteve dhe instrumenteve për punime izolimi dhe përdorimet e tyre;
7. Të shpjegojë llojet e mjeteve dhe instrumenteve për punimet e nënshtresave, shtresave niveluese dhe përdorimet e tyre;
8. Të rendisë llojet e mjeteve dhe instrumenteve për punime të rifiniturës dhe përdorimet e tyre;
9. Të listojë llojet e makinerive për punime në rrugë dhe kanalizime;
10. Të shpjegojë rëndësinë e inventarit të mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës;
11. Të përshkruajë teknikat e mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas manualeve të përdorimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të koordinojë punën e makinerive të gërmimit dhe transportit të dherave;
2. Të kontrollojë përdorimin e mjeteve të punës dhe makinerive për punime betonimi;
3. Të kontrollojë përdorimin e mjeteve të punës dhe makinerive për hekurkthim;
4. Të kontrollojë përdorimin e mjeteve të punës, instrumenteve matëse-niveluese për punime të muraturës;
5. Të kontrollojë përdorimin e mjeteve të punës, instrumenteve matëse-niveluese për punime suvatimi e rifiniture;
6. Të koordinojë punën e makinerive për punime në rrugë e kanalizime;
7. Të kontrollojë mirëmbajtjen e mjeteve dhe makinerive të punës sipas manualeve të përdorimit.

Kriteret e vlerësimit

- Koordinon punën e makinerive të gërmimit të dherave, sipas ngarkesës dhe proceseve të punës;
- Koordinon punën e makinerive të transportit të dherave, sipas ngarkesës dhe proceseve të punës;

- Kontrollon përdorimin e makinerive të përgatitjes së betonit, sipas kushteve teknike të zbatimit dhe manualeve përkatëse;
- Kontrollon përdorimin e mjeteve të punës për ngjeshjen e betonit, sipas kushteve teknike të zbatimit dhe manualeve përkatëse;
- Kontrollon përdorimin e mjeteve të punës për prerjen, kthimin dhe lidhjen e armaturës, sipas kushteve teknike të zbatimit dhe manualeve përkatëse;
- Kontrollon përdorimin e mjeteve të punës për ndërtimin e mureve prej tulle, sipas standardeve teknike;
- Kontrollon përdorimin e mjeteve të punës për ndërtimin e mureve prej guri, bazuar në kushtet teknike;
- Kontrollon përdorimin e veglave dhe mjeteve të punës për ndërtimin e mureve me materiale të tjera;
- Kontrollon përdorimin e mjeteve të punës për punimet e suvatimit, bazuar në kushtet teknike dhe manualet përkatëse;
- Kontrollon përdorimin e mjeteve të punës për punimet e shtrimit, bazuar në kushtet teknike dhe manualet përkatëse;
- Kontrollon përdorimin e mjeteve të punës për punimet e veshjes, bazuar në kushtet teknike dhe manualet përkatëse;
- Kontrollon përdorimin e instrumenteve matëse-niveluese për punimet e suvatimit, shtrimit dhe veshjes, bazuar në kushtet teknike dhe manualet përkatëse;
- Kontrollon përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës për punime izolimi, sipas kushtet teknike dhe manualet përkatëse;
- Kontrollon mënyrën e përdorimit të mjeteve dhe makinerive për punime në rrugë, sipas kushteve teknike dhe manualeve përkatëse;
- Kontrollon mirëmbajtjen e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës, sipas manualeve të përdorimit.

NjN-24-IV-0253-25 Sipërmarrje, komunikimi etik dhe edukimi i karrierës

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë menaxhimin dhe rëndësinë në zhvillimin e biznesit, strukturat dhe rregulloret e brendshme të organizatës;
2. Të përshkruajë parimet bazë të legjislacionit të punës dhe të tatim taksave;
3. Të klasifikojë llojet e dokumentacioneve;
4. Të shpjegojë llojet e planeve periodike;
5. Të përshkruajë mënyrën e plotësimit të një urdhri pune;
6. Të shpjegojë mënyrën e llogaritjeve të volumeve, materialeve dhe kohës së punës;
7. Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së një oferte;
8. Të përshkruajë elementët e llogaritjes së kostos dhe çmimit të një shërbimi;
9. Të shpjegojë llojet e faturave dhe mënyrën e plotësimit të tyre;
10. Të diskutojë teknikat e marketingut në fushën e ndërtimit;

11. Të përshkruajë rëndësinë dhe teknikat e komunikimit;
12. Të shpjegojë standardet e kodit të etikës;
13. Të shpjegojë teknikat e punës në grup;
14. Të përshkruajë teknikat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
15. Të listojë rregullat e komunikimit hierarkik dhe me palët e treta;
16. Të interpretojë terminologjinë profesionale;
17. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj..

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin e fushës, lidhur me aktivitetin që kryen;
2. Të plotësojë plane ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
3. Të regjistrojë të dhënat e faturave dhe përgatitjes së një oferte;
4. Të kontrollojë çmimet e tregut të materialeve bazuar në standardet e ndërtimit;
5. Të llogarisë koston e materialeve dhe çmimin e një shërbimi;
6. Të kryejë blerje të materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme;
7. Të llogarisë çmimin përfundimtar për punimet/shërbimet e ofruara;
8. Të plotësojë procesverbalin/dokumentin e dorëzimit të punimeve të klienti;
9. Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar një projekt-ide sipërmarrëse (për të zhvilluar dhe zbatuar një buxhet të caktuar);
10. Të aplikojë parimet e ekonomisë së lirë të tregut në situata të ndryshme;
11. Të përdorë teknologjitë bashkëkohore për proceset e punës në specialitetin “Teknik i mesëm ndërtimi”;
12. Të transmetojë në kohë tek bashkëpunëtorët njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
13. Të përdorë literaturën bashkëkohore;
14. Të marrë pjesë në panaire dhe ekspozita, trajnime dhe kurse teknike;
15. Të zbatojë procedurat e sipërmarrjes në fushën e ndërtimit;
16. Të zbatojë teknikat e marketingut;
17. Të zbatojë teknikat e komunikimit;
18. Të zbatojë standardet e kodit të etikës në punë;
19. Të respektojë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj..

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin e lidhur me aktivitetin që kryen;
- Harton një plan të thjeshtë biznesi, sipas specifikave përkatëse;
- Plotëson saktë planet periodike të punës, në përputhje me detyrat;
- Zbaton kushtet paraprake dhe procedurat për fillimin e një biznesi në fushën e ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi;
- Zbaton teknikat e duhura të marketingut;

- Merr periodikisht informacionin nga tregu për çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve;
- Përgatit oferta për produktet/shërbimet që do të ofrojë, sipas llojit të shërbimit;
- Kryen llogaritje të sakta të kostos së një shërbimi të kryer sipas detyrës së dhënë;
- Llogarit çmimin përfundimtar për shërbimet e ofruara, sipas rregullave referuar çmimeve të tregut;
- Bashkëpunon me institucione financiare, sipas legjislacionit dhe nevojës;
- Plotëson lloje të ndryshme të faturave, sipas produktit/shërbimit që do të ofrojë;
- Harton, ruan dhe arkivon raportet ditore, javore, mujore të punës, sipas rregullores së brendshme;
- Shkëmben udhëzime me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës duke përdorur terminologji profesionale dhe të qartë në komunikim;
- Vlerëson veten lidhur me mungesat në aftësi referuar proceseve të punës;
- Ndjek trajnimet për ngritje profesionale dhe teknika të reja në punë, sipas teknologjisë bashkëkohore;
- Transmeton njohuritë dhe teknikat e reja në punë tek bashkëpunëtorët, sipas procesit të punës;
- Merr pjesë rregullisht në panairë dhe ekspozita në fushën e ndërtimit;
- Zbaton rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal, sipas kodit të etikës;
- Zbaton kodin e etikës, sipas rregullores së brendshme;
- Punon në grup, sipas parimeve të punës në grup;
- Përdor terminologjinë e duhur profesionale;
- Zbaton rregullat e komunikimit me klientët;
- Zbaton teknikat e motivimit për të arritur një komunikim të mirë me të tjerët;
- Zgjidh ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët, duke përdorur teknikat e duhura;
- Raporton tek mbikëqyrësi për detyrën e kryer, duke përdorur terminologji të qartë dhe profesionale;
- Respekton në mënyrë korrekte nivelet hierarkike dhe rëndësinë e komunikimit etik në organizatë;
- Zbaton rregullat për mbrojtjen e të dhënave sipas legjislacionit;
- Zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj., në komunikimin me të tjerët.

NjN-02-IV-0254-25 Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit në ndërtim eficient

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë legjislacionin në fuqi për rregullat e sigurimit teknik;
2. Të përshkruajë rregullat për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë gjatë procesit të punës;
3. Të shpjegojë masat mbrojtëse gjatë punimeve të gërmimit;
4. Të shpjegojë masat mbrojtëse gjatë punimeve në lartësi;
5. Të përshkruajë rregullat për mbrojtjen nga rryma elektrike, mbrojtjen nga shoku elektrik, mbrojtjen nga efektet termike dhe mbirryma;
6. Të interpretojë manualët teknike dhe udhëzimet për përdorimin e pajisjeve;
7. Të shpjegojë rëndësinë e sinjalistikës në mjedisin e punës;

8. Të interpretojë procedurat e evakuimit në raste emergjence;
9. Të argumentojë përdorimin e mjeteve të mbrojtjes kundër zjarrit dhe sistemet e ndërhyrjes së shpejtë (MNZSH);
10. Të klasifikojë llojet e pajisjeve të ndihmës së parë dhe metodat e aplikimit të tyre në situata emergjente;
11. Të përshkruajë procedurat e dhënies së ndihmës së parë;
12. Të shpjegojë pajisjet mbrojtëse individuale, kolektive dhe përdorimin e tyre;
13. Të analizojë karakteristikat e një mjedisi të qëndrueshëm në ndërtim;
14. Të diskutojë strategjitë për ndarjen e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit në proceset ndërtimore;
15. Të theksojë rëndësinë e përdorimit racional të energjisë, ujit, materialeve ndërtimore dhe burimeve të tjera duke vlerësuar ndikimin e tyre në mjedis;
16. Të listojë rregullat për depozitimin, ruajtjen dhe menaxhimin e mbetjeve gjatë punimeve të ndërtimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kontrollojë/zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë proceseve të punës;
2. Të koordinojë masat për të minimizuar rrezikun e aksidenteve në vendin e punës;
3. Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;
4. Të kontrollojë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive;
5. Të kontrollojë zbatimin e politikave dhe strategjive për mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e burimeve të qëndrueshme.

Kriteret e vlerësimit

- Kontrollon/zbaton standardet dhe legjislacionin shqiptar lidhur me rregullat e sigurimit teknik në punë;
- Kontrollon zbatimin e rregullave të sigurimit teknik për veten dhe ekipin në punimet në lartësi;
- Kontrollon zbatimin e rregullave të sigurimit teknik gjatë punimeve elektrike me tension;
- Kontrollon përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive në punë, sipas procedurës së punës;
- Kontrollon përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas manualeve përkatëse;
- Kontrollon/përdor pajisjet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, sipas rregullores;
- Kontrollon zbatimin e hapave për vendosjen e sinjalistikës në mjedisin e punës;
- Identifikon dhe raporton tek personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë teknike, sipas rastit;
- Jep ndihmën e parë në rast aksidenti, sipas rregullave përkatëse;
- Përdor mjetet e dhënies së ndihmës së parë me korrektësi;
- Mbikëqyr/zbaton procedurat e evakuimit për raste emergjente, sipas protokolleve;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave përkatëse për depozitimin e mbetjeve në përputhje me rregulloret e mjedisit;

- Mbikëqyr zbatimin e rregullave për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit, sipas legjislacionit;
- Merr masa për të minimizuar rrezikun e aksidenteve në vendin e punës, sipas rregullores së sigurimit teknik;
- Mbikëqyr zbatimin e politikave dhe strategjive për mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e burimeve të qëndrueshme;
- Zbaton protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme;
- Ndjek trajnime periodike për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punimeve të ndërtimit	9	NjN-02-IV-0242-25
2	Vizatimi teknik në fushën e ndërtimit	8	NjN-02-IV-0243-25
3	Dokumentacioni teknik	5	NjN-02-IV-0244-25
4	Punime për ndërtimin e strukturës së objektit	24	NjN-02-IV-0245-25
5	Punime për ndërtimin e shtresave dhe dyshemeve	8	NjN-02-IV-0246-25
6	Punime të rifiniturave në ndërtim	12	NjN-02-IV-0247-25
7	Monitorimi i punimeve të instalimeve elektrike, hidraulike, mekanike, teknologjike dhe të montimit	4	NjN-02-IV-0248-25
8	Punime të infrastrukturës rrugore dhe sistemeve të kanalizimeve dhe shkarkimeve	8	NjN-02-IV-0249-25
9	Materialet në fushën e ndërtimit	3	NjN-02-IV-0250-25
10	Mjetet dhe pajisjet e punës në fushën e ndërtimit	3	NjN-02-IV-0251-25
11	Kontrolli i cilësisë së punimeve në ndërtim	5	NjN-02-IV-0252-25
12	Sipërmarrje, komunikimi etik dhe edukimi i karrierës	5	NjN-24-IV-0253-25
13	Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit në ndërtim eficient	6	NjN-02-IV-0254-25
Totali		100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuara.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe

vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikimi i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: K-B/1-IV-25

K - Kualifikim

B - Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

1 - Numri që identifikon profilin/specializimin e kualifikimit përkatës

IV - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

25 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: NjN-02-IV-0242-25

NjN - Shkronjat tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

02 - Numri që identifikon fushën e Njësisë së të Nxënit

IV - Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0242 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

25 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit